

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

Në çështjen juridike të :**AC-I-22-0095-A0001***Paditëse/Ankuese***K S V, Prishtinë****Kundër:***E paditura*

N.SH. “Marketingu” (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Agron Hoxhaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-0578, të datës 19 janar 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 janar 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditëses është e bazuar.
2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-0578, i datës 19 janar 2022 si dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN097-0052 i datës 3 prill 2015.
3. Obligohet e paditura që për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës t'i paguaj paditëses shumën prej 1,800.00 euro sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 24 prill 2014, paditësja kishte parashtruar një ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së me nr. PRN097-0052 të datës 3 prill 2015, me të cilin vendim kërkesa e paditëses për kompensim për ndërprerje të marrëdhënies së punës në shumën prej 2,067.35 euro ishte refuzuar si e pavlefshme për arsye se AL kishte konstatuar se ndërmarrja në fjalë nuk ka pasur aktivitet të paktën prej vitit 1999 dhe punëtorët nuk janë pushuar si pasojë e vendimit të inicimit të procedurës së likuidimit apo ndonjë veprimi tjetër të AKP-së por nuk kanë punuar shumë më herët se vet AKP apo AKM të krijoheshin.

Në ankesë paditësja thekson se AL nuk e kishte kontestuar fare faktin se ankuesja ishte punëtore e ndërmarrjes në fjalë dhe as lartësinë e kompensimit, prandaj konsideron se nuk është e nevojshme as të argumentohet lidhur me këtë çështje. Mirëpo pala kundërshtare konsideron se e paditura në mënyrë jo të plotë e ka vlerësuar gjendjen faktike të rastit dhe ka nxjerrë konstatime të gabuara. Paditësja konsideron se në mënyrë të padrejtë i është pamundësuar qasja në vendin e punës, rrjedhimisht edhe realizimi i të ardhurave personale që paraqet shkelje të së drejtave nga marrëdhënia e punës dhe trajtim diskriminues gjatë tërë periudhës së pasluftës deri më tani. Tutje, konsideron se si rrjedhojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike është zbatuar në mënyrë të gabuar edhe e drejta materiale. Me datë 1 gusht 2014, paditësja kishte pranuar letër pezullimin nga marrëdhënia e punës dhe shihet që kjo ndërprerje e marrëdhënies së punës është shkaktuar si pasojë e veprimeve administrative të AKP-së. Prandaj, paditësja i kishte propozuar gjykatës që të miratohet ankesa si e bazuar duke shfuqizuar vendimin e AL-së, ashtu që të obligohet e paditura që në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës t'i paguaj ankueses 6 paga mujore neto në shumën prej 300.00 euro, në shumë të përgjithshme 1,800.00 euro, shumën prej 267.36 euro t'ia paguaj Administratës Tatimore të Kosovës dhe Trustit Pensional të Kosovës si dhe të bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në vlerë prej 104.00 euro.

Ankesës i kishte bashkëngjitur provat si në vijim: kopjen e librezës së punës së paditëses, Gazetën Zyrtare 17/516, Kontratat e punës ndërmjet paditëses dhe N.SH.T “Marketingu” të datës 1 gusht 2000, 1 gusht 2001, 1 gusht 2002, 2 gusht 2004, 1 gusht 2006, 3 gusht 2009 si dhe 3 gusht 2012, Njoftimin për të gjithë debitorët dhe pronarët e ndërmarrjes të lëshuar nga

AKP lidhur me fillimin e likuidimit të ndërmarrjes, Njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, formulari për parashtrimin e kërkesës jo-pronësore në likuidim, vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN097-0052 të datës 3 prill 2015, autorizimin për përfaqësim si dhe kopjen e letërnjoftimit të paditëses.

Me datë 5 tetor 2017, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën theksohet se siç është konfirmuar edhe nga vet ankesa, të gjithë punëtorët e N.SH-së rreshtën së punuari në fakt që nga viti 1991 kur masat e dhunshme hyn në fuqi. Më pas nga 1999 në vazhdim, OSBE hyri në ambientet e N.SH-së dhe deri në momentin e hyrjes së kësaj ndërmarrje në likuidim, kjo e fundit nuk ka gjeneruar asnjë aktivitet ekonomik apo komercial. Parashtruesja konsideron se marrëdhënia e saj e punës është ndërprerë si pasojë e likuidimit dhe për këtë ndër të tjera referon te shkresa e datës 1 gusht 2014 ku parashtruesja njoftohet për fillimin e likuidimi. Pala kundërshtare thekson se njoftimi në fjalë është një njoftim shabllon që njofton palët për fillimin e likuidimit të N.SH-së dhe pasojat ligjore që ka ky proces. Pala kundërshtare gjithashtu dëshiron të sqaroj parashtruesin se referimi i kontratës fiktive në vendim nuk i referohet kontratës së lidhur në vitin 1998 ndërmjet OSBE dhe ndërmarrjes në fjalë. Parashtruesja nuk mund të ofroj përgjigje pozitive dhe prova për asnjë nga këto pyetje pasi që është fare e qartë se N.SH nuk kishte operuar më që nga viti 1999. Andaj duke pasur parasysh këto, e paditura i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet ankesa e paditëses si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i ankimuar i AL-së. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur një kërkesë për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit të datës 18 gusht 2016.

Me datë 23 tetor 2017, paditësja kishte paraqitur një përgjigje në mbrojtje të AKP-së në të cilën i përsëritë pretendimet si në ankesën ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit, ndërsa i propozon gjykatës që të miratoj në tërësi kërkesëpadinë e palës paditëse si të bazuar, ashtu siç është propozuar nga ana e paditësit në ankesën e tij drejtuar gjykatës.

Me datë 6 nëntor 2017, AKP-ja kishte paraqitur kundërpërgjigje në përgjigje të paditëses në të cilën propozon që ankesa e paditëses të refuzohet si e papranueshme ose e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 19 janar 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-0578 kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses, ndërsa kishte vërtetuar vendimin e Autoritetit të

Likuidimit me nr. PRN097-0052 të datës 3 prill 2015. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se nuk është kontestuese se N.SH në vitin 1991 nga Republika e Serbisë janë vënë masa të dhunshme dhe si pasojë e kësaj ka pasur largim masiv nga puna të punëtorëve shqiptar që kanë qenë të punësuar në N.SH. Pastaj nuk është kontestues fakti se në vitin 1998 në objekte në kuadër të qytetit që është quajtur Objekti i Bankës së Lubjanës në Prishtinë nga baza e kontratës së qirasë është vendosur në shfrytëzim Misioni i OSBE, ndërsa pas përfundimit të luftës në të njëjtin objekt është vendosur përsëri në shfrytëzim Misioni i OSBE. Gjithashtu ishte vërtetuar fakti se ndërmarrja pas luftës e deri në procedurë të likuidimit nuk ka ushtruar asnjë aktivitet ekonomik. Nuk është kontestuese as fakti se nga viti 2000 e tutje paditësja me ndërmarrjen në fjalë kishte pasur kontratë pune në vazhdimësi si dhe kontratës e fundit me 3 gusht 2012 përkundër faktit të mos funksionimit ekonomik të N.SH-së. Gjykata vlerëson se për objektin që pretendon paditësi dhe e paditura se kanë qenë aset i N,SH “Marketing” nuk kanë ofruar asnjë dëshmi pronësore, pastaj se nënshkruesi i kontratës në emër të ndërmarrjes si drejtor Agim Kastrati për këtë drejtor nuk ka ofruar dëshmi se i njëjti në procedurë të brendshme sipas akteve të N.SH-së është zgjedhur drejtor dhe zgjedhja është pranuar nga APM/AKP. Pastaj, asnjëra palë nuk ka ofruar dëshmi se kontrata e punës është përmbushur dyanshëm sepse për të prodhuar efekt juridik ajo duhet të përmbushet nga të dy palët. Gjithashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret paditëses i mungon baza juridike për të kërkuar kompensimin e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës që është e njohur sipas dispozitës së nenit 40.1.6.2. Gjykata vlerëson se dëmshpërblimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës është normuar që punëtorëve të cilëve ju ndërpritet njëanshëm kontrata nga punëdhënësi ata një periudhë të caktuar ta përballojnë më lehtë në aspektin ekonomik, mirëpo në këtë rast paditësja nuk ka punuar fare te e paditura, në momentin e fillimit të procedurës së likuidimit.

Me datë 22 shkurt 2022, paditësja (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-15-0578 të datës 19 janar 2022 (më tutje aktgjykimi i ankimuar), për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të aprovoj ankesën e paditëses si të bazuar dhe të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar duke aprovuar ankesën e paditëses të paraqitur ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Në ankesë theksohet se paditësja në ankesë kishte bashkëngjitur njoftimin e AKP-së për ndërprerjen e

marrëdhënies së punës, e cila si dëshmi vërteton që me veprimin e AKP-së asaj i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat i fillimit të procedurës së likuidimit ndaj N.SH-së. Tutje paditësja kishte kërkuar kompensim në shumën prej 2,067.37 euro aq sa janë kërkuar edhe tek Autoriteti i Likuidimit por që kjo shumë e kërkuar nuk është kontestuar shprehimisht nga e paditura në mbrojtjen në ankesë. Paditësja kërkon nga Kolegji i Apelit që t'i shqyrtoj edhe njëherë të gjitha provat që ekzistojnë në lëndë të cilat paditësja i ka sjellë me ankesë dhe pas administrimit të provave dhe duke i marrë parasysh faktet e theksuara me ankesë i propozon si më lartë. Ankesës i kishte bashkëngjitur Aktgjykimin e ankimuar.

Me datë 20 shtator 2023, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e palës kundërshtare në të cilën theksohet se argumentet e paraqitura në ankesë janë të përsëritura. Andaj i propozon Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të refuzoj ankesën e paditëses si të pabazuar, ndërsa të vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditëses është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS, C-IV-15-0578 i datës 19 janar 2022 si dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN097-0052 të datës 3 prill 2015 dhe ankesa e paditëses aprovohet si e bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditëses për ndërprerje të marrëdhënies së punës në shumën prej 2,067.36 euro, me Vendimin PRN097-0052 të datës 3 prill 2015, ishte refuzuar si e pavlefshme, me arsyetimin se paditësja nuk është pushuar si pasojë e vendimit të inicimit të procedurës së likuidimit apo ndonjë veprimi tjetër të AKP-së por nuk kishte punuar shumë më herët se të krijoheshin AKM apo AKP-ja.

Ankuesi në ankesën e dorëzuar në DHPGJS në shkallë të parë kishte bashkëngjitur si provë: Kontratat e punës për vitet 2000, 2001, 2002, 2004, 2006, 2009 dhe 2012, Njoftimi për të gjithë debitorët dhe pronarët e ndërmarrjes të lëshuar nga AKP për fillimin e likuidimit të ndërmarrjes, kopjen e librezës së punës së paditëses, Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe formularin për parashtrimin e kërkesës jo-pronësore në likuidim. Ndërsa, shkalla e parë e DHPGJS-së e kishte refuzuar ankesën e paditësit me arsyetimin se i njëjti nuk kishte argumentuar para gjykatës se në momentin e likuidimit të ndërmarrjes ka qenë punëtor aktiv në ndërmarrje dhe se i është ndërprerë kontrata për shkak të likuidimit të ndërmarrjes. Njëkohësisht në ankesën e tij të dorëzuar në shkallë të parë paditësi në propozimin për gjykatën kërkon që në emër të kompensimit për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës e paditura t'i paguaj shumën prej 6 (gjashtë) paga mujore në shumën prej 300.00 euro, që në shumë të përgjithshme arrin shumën prej 1,800.00 euro.

Kolegji i Apelit i DHPGJS-së konsideron që refuzimi i kërkesës për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nuk ishte veprim i drejtë nga ana e shkallës së parë të DHPGJS-së.

Nga Njoftimi i AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, shihet që paditëses i është ndërprerë parashkrimi i kërkesës për kompensim për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kur kishte filluar privatizimi i ndërmarrjes në fjalë, e cila përmes këtij njoftimi ishte njoftuar se nëse ka ndonjë kërkesë ndaj ndërmarrjes ta dorëzoj pranë AL-së.

Prandaj, paditësja duke vepruar konform njoftimit që i është bërë me datë 1 gusht 2014, ashtu siç theksohet edhe në vendimin e Autoritetit të Likuidimit, me datë 3 shtator 2014 që është brenda afatit për dorëzimin e kërkesave kishte paraqitur kërkesën për kompensim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ashtu siç ishte njoftuar nga AKP-ja.

E paditura nuk e kishte kontestuar shumën e kërkuar nga paditësja dhe në këtë rast faktet e pakontestuar konsiderohen si të vërtetuara sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Kolegji i Apelit gjithashtu vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e AKP-së se paditësja nuk ka dëshmuar se në momentin e likuidimit të ndërmarrjes ka qenë punëtor aktive në ndërmarrje dhe se i është ndërprerë kontrata për shkak të likuidimit të ndërmarrjes, për faktin se vet AKP-

ja me anën e Njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës së paditëses të datës 1 gusht 2014 kishte vërtetuar faktin se të njëjtës i është ndërprerë kontrata e punës për shkak të likuidimit të ndërmarrjes.

Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit i njeh të drejtën paditëses në kompensim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në shumën e kërkuar prej 1,800.00 euro, e cila duhet të paguhet nga Autoriteti i Likuidimit sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e Likuidimit.

Kolegji i Apelit refuzon kërkesën për pagimin e obligimeve ndaj Administratës Tatimore si dhe Trustit pensional të Kosovës në shumë prej 267.36 euro, me arsyetimin se kërkesa nuk ishte specifikuar qartë. Për më tepër kërkesa lidhur me pagesën e trustit pensional nuk përfshihet në kërkesën për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e paditëses duhet të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 11 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
